



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVA  
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT  
MUNICIPALITY OF DEÇAN  
OPSTINA DEÇAN



# PLANI I PUNËS PËR VITIN 2025

DREJTORIA PËR EKONOMI DHE ZHVILLIM  
(01 Janar 2025 – 31 Dhjetor 2025)

		DREJTORIA PËR EKONOMI DHE ZHVILLIM REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E DEÇANIT - OPSTINA DEÇAN - DEÇAN MUNICIPALITY	
NR. I DOKUMENTIT	DR. EK. ZHVILLIM	NR. I DOKUMENTIT	754
NR. I STRUKTURËS	11	NR. I DATËS	09.01.25
NR. I DATËS			

Miratoj:  
Drejtori për EZH  
Isuf Demhasaj

Deçan, 2025

**I nderuar Kryetar,**

**I nderuar Nënkyetar,**

Ndërsa hyjmë në vitin 2025, Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim e Komunës së Deçanit është e angazhuar të përmbush një varg objektivash ambicioze dhe të qëndrueshme, të përqëndruara në zhvillimin e turizmit dhe nxitjen e vlerave natyrore të rajonit tonë. Me këtë Plan të Punës, ne synojmë të vendosim Deçanin si një qendër të njohur për turizmin natyror dhe kulturor, duke shtuar vlerë jo vetëm për ekonominë lokale, por edhe për jetën e komunitetit.

**Emri i Planit të Punës:** Deçani qendër e vlerave natyrore dhe turistike.

**Periudha e Implementimit të Planit të Punës:** 01.01.2025 - 31.12.2025

**Territori i Implementimit të Planit të Punës:** Komuna e Deçanit (zona urbane, rurale dhe malore)

Përmbajtja e planit të punës:

1. Përfituesit përfundimtar të Planit të Punës.....	4
2. Misioni i planit të punës.....	4
3. Qëllimi i planit të punës.....	5
4. Objektivat e planit të punës.....	5
5. Plani i aktiviteteve dhe projekteve 2025.....	6

### **Përfituesit përfundimtar të Planit të Punës:**

Përfituesit përfundimtar të Planit të Punës janë qytetarët e Komunës së Deçanit, pronarët e bizneseve prodhuese dhe tregtare, pronarët e hoteleve dhe bujtinave, organizatat jo-qeveritare lokale dhe tour operatorët lokal.

### **Misioni i Planit të Punës:**

Misioni i Planit të Punës të Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim është:

1. Krijimi i mundësive për zhvillim ekonomik dhe turistik të Komunës së Deçanit.
2. Përmbyllja e strategjive dhe Planit Zhvillimor Komunal për krijimin e kushteve për promovimin e vlerave rurale dhe malore turistike të komunës.
3. Mbështetja e bizneseve të vogla, të mesme dhe të mëdha që janë prodhuese dhe tregtare.
4. Rritja e punësimit në komunë.
5. Krijimi dhe ngritja e kapaciteteve hoteliere dhe bujtinave në zonat rurale dhe malore.
6. Ngritja e kampeve në Bjeshkët e Deçanit dhe shenjëzimi i të gjitha shtigjeve për ciklizëm dhe ecje, si dhe shtigjeve të tjera në të gjitha, tetëmbëdhjetë Bjeshkët e Deçanit.

## **Qëllimi i Planit të Punës:**

Qëllimi i Planit të Punës për vitin 2025 është të krijojë një mjedis të përshtatshëm për zhvillimin e Komunës së Deçanit në fushën e ekonomisë dhe turizmit. Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim synon të ndihmojë në rritjen e zhvillimit ekonomik dhe të turizmit, përmes krijimit të kushteve të favorshme për bizneset, promovimit të vlerave natyrore dhe kulturore të komunës, dhe ngritjen e kapaciteteve turistike.

Kështu, plani synon të kontribuojë në rritjen e punësimit dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve të Komunës së Deçanit. Gjithashtu, qëllimi është të kujdeset për mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore të kësaj zone dhe të prezantojë atë për turistët vendas dhe ndërkombëtarë.

Qëllimi i Planit të Punës është për Drejtorinë për Ekonomi dhe Zhvillim të krijojë kushte të qëndrueshme për zhvillimin e turizmit dhe ekonomisë në Komunën e Deçanit. Drejtoria synon të:

1. Promovojë turizmin në komunë.
2. Mbrojë dhe promovojë vlerat natyrore dhe kulturore të komunës.
3. Bashkëpunojë me organizatat qeveritare dhe jo-qeveritare, ndërkombëtare.
4. Zhvillojë ekonominë dhe turizmin në komunë dhe të sigurojë financim për këto fusha.
5. Nxisë bizneset, organizatat qeveritare dhe jo qeveritare, dhe tour operatorët lokal në zhvillimin dhe promovimin e turizmit veror dhe dimëror, duke rritur numrin e turistëve në zonat rurale dhe malore.

## **Objektivat e Planit të Punës për vitin 2024 janë:**

1. Zhvillimi ekonomik dhe social i Komunës së Deçanit.
2. Promovimi i turizmit veror dhe dimëror në komunë.
3. Ngritja e kapaciteteve turistike të komunës dhe fuqizimi i bizneseve prodhuese dhe tregtare lokale.
4. Krijimi i brendeve të ndryshme prodhuese.
5. Ruajtja dhe promovimi i vlerave natyrore, tradicionale, kulturore dhe fetare të komunës.
6. Përmirësimi i infrastrukturës turistike dhe shërbimeve për vizitorët.
7. Rritja e numrit të aktiviteteve turistike dhe ngjarjeve kulturore në komunë.
8. Përdorimi i teknologjisë për të promovuar turizmin dhe shërbimet lokale.
9. Bashkëpunimi më i ngushtë me autoritetet qendrore dhe ndërkombëtare për të mbështetur zhvillimin e turizmit.
10. Hartimi i Pakos Turistike: Planifikimi për hartimin e një pako turistike të re, duke përfshirë oferta të reja për turistët, si udhëtime aventuristike, aktivitete të natyrës, ose oferta kulturore të reja.
11. Përmirësimi i cilësisë së ajrit dhe mjedisit për të rritur atraktivitetin e komunës për turistët.

12. Ngritja e ndërgjegjësimit dhe edukimit të komunitetit dhe bizneseve në lidhje me turizmin e përgjegjshëm dhe të qëndrueshëm.

AKTIVITETI	BARTESI	PERIUDHA E IMPLMENTIMIT	FONDET	REZULTATET E PRITURA	RREZIQET
1.Regjistrimi i bizneseve dhe shërbime tjera rreth kërkesave të bizneseve	DEZH ARBK	Janar 2025 Dhjetor 2025	Komuna e Deçanit ARBK	-Shërbime më të mira për bizneset lokale. -Fuqizimi i bizneseve. -Mbështetja dhe informimi i bizneseve.	-Mos kryerja e dokumenteve me kohë i bizneseve. -Ligjet jo të favorshme për biznese. -Mungesa e mjeteve financiare për mbështetjen e bizneseve.
2.Panairi Veror-2025	Komuna e Deçanit, Institucionet Qendrore, Organizatat Jo-Qeveritare Vendore dhe Ndërkombëtare bizneset lokale, prodhuese vendore dhe të vendeve fqinje	Qershor 2025	Komuna e Deçanit	-Promovimi i produkteve vendore. -Krijimi i bashkëpunimit mes bizneseve. -Shitja dhe marketingu i bizneseve prodhuese lokale. -Promovimi i produkteve vendore.	-Mos pjesëmarrja e bizneseve në panair. -Mungesa e mjeteve financiare për organizimin e panairit.
3.Projekte kapitale për promovimin e turizmit dhe ngritjen e kapaciteteve turistike	Komuna e Deçanit DEZH Donator vendor dhe ndërkombëtar	Janar 2025 Dhjetor 2025	Komuna e Deçanit - Mjete Kapitale Institucione Qendrore Organizata Jo-Qeveritare	- Promovimi i turizmit veror dhe dimëror në nivelin rajonal dhe ndërkombëtar	-Mungesa e mjeteve financiare. -Mungesa e kapaciteteve profesionale.

			Vendore dhe Ndërkombëtare Bizneset Lokale	-Ngritja kapaciteteve turistike si në zonat rurale dhe malore. -Ngritja e kapaciteteve shërbyese me të mira për turistë. -Krijimi i mundësive për zhvillim ekonomik dhe punësim.	-Mungesa e bashkëpunimit dhe tour operatorëve lokal. -Mungesa e shoqatave bëshkatave lokale.
4.Krijimi i bashkëpunimit me pronarët e kullave, bujtinave, tour operatorëve lokal dhe rajonal, shoqatave bëshkatave lokale dhe rajonale dhe objekteve fetare dhe krijimi i bazës së të dhënave për numrin turistëve dhe kërkesave dhe nevojave të tyre.	DEZH, Pronarët e kullave, bujtinave dhe përfaqësuesit e objekteve fetare, shoqatat bëshkatave lokale dhe rajonale, tour operatorët lokal dhe rajonal, agjenci të ndryshme.	Janar 2025 Dhjetor 2025	Komuna e Deçanit Fonde nga Organizata Jo-qeveritare vendore dhe ndërkombëtare	-Krijimi i bazës së të dhënave për numrin e turistëve. -Bashkëpunimi me i mire mes institucioneve dhe përfaqësuesëve tjerë lokal. -Shërbime me të mira për turistët. -Zhvillimi ekonomik i komunës.	-Mos bashkëpunimi i duhur i personave relevant në këto fusha. -Mos regjistrimi i turistëve gjatë vizitave të tyre në zonat rurale dhe malore. -Mungesa e mjeteve financiare dhe kapacitetet profesionale.
5.Festivali i punimeve artizanale dhe ushqimeve tradicionale	DEZH Donator Organizata Qeveritare dhe Jo-qeveritare, Prodhuesit e Punimeve Artizanale, Ushqimit etj.	Gusht 2025	Komuna e Deçanit Fonde nga Organizata Jo-Qeveritare Vendore dhe Ndërkombëtare	-Promovimi i prodhimeve vendore me punë dore. -Mbështetja e prodhuesëve artizanal (veçanërisht grave). -Ruajtja e vlerave kulturore dhe tradicionale.	-Mungesa e mjeteve financiare për organizmin e festivalit. -Kushtet klimatike. -Mos krijimi i bashkëpunimit mes institucioneve dhe prodhuesëve te

					punimeve artizanale.
6. Formimi i ofertës së pakos turistike për zonat rurale dhe malore në Komunën e Deçanit.	Komuna e Deçanit DEZH Donator vendor dhe ndërkombëtar Shoqatat bjeshkatore, Tour operatorët, Ekspert të fushës së ekonomisë dhe turizmit	Janar - Dhjetor 2025	Komuna e Deçanit Fonde nga Organizata Jo-qeveritare Vendorë dhe Ndërkombëtare	-Promovimi i vlerave natyrore dhe kulturore të komunës. -Shërbime me të mira turistike si në zonat rurale dhe malore. -Krijimi i pakos digjitale për promovimin e vlerave turistike. -Rritja e vizitoreve në zonat rurale dhe malore dhe ngritja e kapaciteteve mikpritëse profesionale	-Mungesa e mjeteve financiare për krijimin e ofertës turistike. -Kushtet klimatike -Mungesa e kapaciteteve profesionale dhe shoqatave lokale. -Mos informimi apo pasqyrimi jo i duhur medial dhe në rrjetet sociale.
7. Shenjzimi i shtigjeve për ecje dhe çiklizëm dhe shtigjeve tjera në zonat rurale dhe malore në tetëmbëdhjetë bjeshkët e Komunës së Deçanit	Komuna e Deçanit DEZH Donator vendor dhe ndërkombëtar Shoqatat jeshkatore, Tour operatorët, Ekspert të fushës së ekonomisë dhe turizmit	Janar - Dhjetor 2025	Komuna e Deçanit DEZH Donator vendor dhe ndërkombëtar Shoqatat bjeshkatore, Tour operatorët,	-Shenjzimi i të gjitha shtigjeve për ecje dhe çiklizëm. -Shërbime me të mira për turistë. -Informimi më i mirë për turistët.	-Mungesa e mjeteve financiare. -Kushtet klimatike. -Shkatërrimi i tabelave dhe shenjave për ecje dhe çiklizëm. -Mos publikimi në rrjetet të ndryshme sociale i shtigjeve.
8. Subvencione dhe mbështetje financiare për bizneset prodhuese,	Komuna e Deçanit DEZH	Janar - Dhjetor 2025	Komuna e Deçanit Organizata	-Nxitja e të rinjëve për hapjen e bizneseve.	-Mungesa e mjeteve financiare -Procedurat aplikuese.



bizneset e vogla dhe të mesme	Institucionet Qeveritare dhe Ndërkombëtare Organizatat Jo-Qeveritare bizneset në Deçan		Jo-Qeveritare Vendore dhe Rajonal, Ndërkombëtare	-Mbështetje e bizneseve ekzistuese. -Fuqizimi i bizneseve lokale dhe krijimi i vendeve të reja të punës dhe zhvillimi ekonomik i komunës. -Krijimi i mundësive më të mira për punë. -Krijimi i bashkëpunimit më të mirë mes institucioneve dhe qytetarëve. -Krijimi i mundësive për bizneset lokale dhe prodhuesit vendor për pjesëmarrje në panairë të ndryshme në vende dhe jashtë vendit.	-Mos plasimi i duhur në tregun lokal dhe rajonal i prodhimeve.
09.Mbajtja e Kampit Veror për të rinjtë	Komuna e Deçanit DEZH	Gusht 2025	Komuna e Deçanit DEZH	-Promovimi i turizmit përmes kampingut njëditorë breg Lumbardhit të Deçanit. -Njoftimi me pajisjet e kampingut dhe rëndësinë e tij -Shfrytëzimi i lumit dhe bukurisë së tij. -Njoftimi me Via Ferrata si	-Mos pjesëmarrja në kamping e të rinjeve -Kushtet klimatike

				atraksion turistik	
10. Inicimi dhe krijimi i brendit të produkteve vendore lokale (prodhimit të qumështi, pemëve, mjaltës, gështenjës, ujit natyral dhe ujit mineral) etj.	Komuna e Deçanit, prodhuesit lokal, Institucionet vendore dhe ndërkombëtare, Ekspert të fushave të ndryshme	Janar - Dhjetor 2025	Komuna e Deçanit Organizata Jo-Qeveritare Vendore, Rajonale dhe Ndërkombëtare	-Promovimi i produkteve natyrale dhe tradicionale të komunës. -Fuqizimi i prodhueseve vendor dhe zhvillimi ekonomik i komunës. -Ruajtja e vlerave lokale dhe krijimi i mundësive për bizneset. -Bashkëpunim më i mirë me qytetarët e Komunës së Deçanit	-Mungesa e mjeteve financiare për fuqizimin e prodhueseve. -Mungesa e laboratorëve adekuat për cilësinë e prodhimit. -Mos plasimi i duhur në tregun lokal dhe rajonal. -Mungesa e promovimit në nivel lokal dhe ndërkombëtar.
11. Inicimi i procedurave dhe krijimi i Strategjisë Lokale të Zhvillimit Ekonomik për Komunën e Deçanit.	DEZH, Organizata Jo-Qeveritare dhe Vendore, Organizatat Ndërkombëtare, Ekspert të fushave të ndryshme	Janar - Dhjetor 2025	Komuna e Deçanit, Donator Vendor dhe Ndërkombëtar	-Krijimi i një plani afatgjatë për zhvillimin ekonomik. -Gjendja ekonomike dhe sociale e tanishme. -Veprimet që duhet të merren për zhvillimin ekonomik, turizmit dhe bizneseve në Deçan. -Nxitja e bashkëpunimit mes institucioneve dhe qytetarëve.	-Mungesa e përkrahjes financiare. -Mos përkrahja nga institucionet lokale dhe qendrore. -Mos zbatimi i kësaj strategjie pas hyrjes në fuqi.
12. Bashkëpunimi me institucionet qendrore,	DEZH, Ministrinë, Organizatat Jo-	Janar - Dhjetor 2025	Komuna e Deçanit, Institucionet	-Krijimi i bashkëpunimit	-Mos bashkëpunimi i

organizata ndërkombëtare, organizata jo-qeveritare dhe ndërkombëtare, me ekspert të ndryshëm dhe institucione tjera shoqërore.	qeveritare vendore dhe ndërkombëtare, Ekspert të ndryshëm, Institucione tjera shoqërore.		Qendrore dhe Organizata tjera vendore dhe ndërkombëtare.	më të mirë mes institucioneve. -Krijimi i kushteve më të mira sociale dhe ekonomike të qytetarëve. -Informimi i duhur i qytetarëve për çështje të ndryshme. -Zhvillimi ekonomik i komunës.	mirë mes institucioneve. -Procedurat administrative. -Mos planifikimi i duhur buxhetor, i kohës dhe mungesa mjeteve administrative.
13. Informimi dhe mbështetje bizneseve lokale në aplikime të ndryshme për grante si në institucionet qendrore ashtu dhe ndërkombëtare	DEZH, Ministritë Organizatat vendore dhe ndërkombëtare Bizneset Lokale	Janar - Dhjetor 2025	Komuna e Deçanit, Institucionet Qendrore dhe Organizata tjera vendore dhe ndërkombëtare.	-Informimi më i mirë i qytetarëve. -Krijimi i mundësive për ngritjen e kapaciteteve prodhuese. -Fuqizimi i bizneseve lokale. -Zhvillimin ekonomik i komunës.	-Mos informimi me kohë i bizneseve. -Mungesa e kuadrove profesionale brenda drejtorisë dhe të bizneset. -Procedurat aplikuese të vështira.
14. Funksionalizimi dhe punësimi i dy personave që njohin gjuhë të huaj dhe fushën e turizmit në Qendrën Informuese Turistike.	Komuna e Deçanit DEZH	Janar - Dhjetor 2025	Komuna e Deçanit, Institucionet Qendrore dhe Organizata tjera vendore dhe ndërkombëtare.	-Informimi më i mirë i turistëve për vlerat natyrore dhe kulturore të komunës. -Rritja e numrit të turistëve. -Promovimi i turizmit në nivel vendor dhe ndërkombëtar.	-Mungesa e materialeve promovuese. -Mungesa e kuadrove profesionale në fushën e turizmit. -Mungesa e mjeteve buxhetore për punësimin e personave dhe mos funksionalizimi i duhur i

					Qendrës Informuese.
15. Projekti Zgjerimi i Via Dinarica në Rajonin Ndërkufitarë Kosovë-Shqipëri Komuna e Deçanit-	Komuna e Deçanit Qytetarët e Komunës së Deçanit Shoqata lokale të bjeshkatarëve Projekti NaturKosovo	Janar – Dhjetor 2024-2025	Komuna e Deçanit Bashkimi Evropian Komunitat tjera të përfshira në këtë projekt	-Krijimi i shtigjeve të reja në zonat malore nga Kosova në Shqipëri VIA DINARICA. -Trajnime të anëtarëve shoqatave bjeshkatarë lokale. -Promovim i turizmit malor dhe materialeve tjera promovuese.	-Kushtet klimatike -Procedurat administrative. -Mos pagesa me kohë e mjeteve buxhetore nga ana e komunave.
16. Krijimi i Zyrës së Hartimit të Projekteve në kuadër të drejtorisë dhe punësimi me kohë të caktuar ose të plotë në këtë zyre.	Komuna e Deçanit, Organizata Qeveritare Vendore dhe Ndërkombëtare	Janar - Dhjetor 2025	Komuna e Deçanit Institucionet Qendrore dhe Organizata Vendore dhe Ndërkombëtare	-Mbështetje qytetarëve dhe bizneseve në aplikim për projekte të ndryshme. -Hartimi i projekteve fushën e turizmit dhe zhvillimit ekonomik. -Krijimi i shërbimeve me të mira për qytetarët.	-Mungesa e mjeteve buxhetore. -Mos përkrahja nga institucionet qendrore dhe lokale për hapjen e kësaj zyrjeje.
17. Dita e Qethave	Komuna e Deçanit DEZH Institucionet Qendrore, Organizatat Jo-Qeveritare Vendore dhe Ndërkombëtare Qytetarët e	Korrik 2025	Komuna e Deçanit DEZH Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural Organizatat Jo-Qeveritare	-Ruajtja e vlerave natyrore dhe tradicionale të komunës. -Promovimi i turizmit malor dhe natyror.	-Kushtet klimatike. -Mungesa e mjeteve financiare. -Mungesa e ushqimit natyral dhe blegtorëve në zonat malore.

	Komunës së Deçanit Bizneset Lokale		Vendore dhe Ndërkombëtare	-Promovimi i ushqimit tradicional. -Fuqizimi i blegtorëve dhe pronarëve të bujtinave. -Ngritja e kapaciteteve mikpritëse të pronarëve të staneve në zonat malore. -Rritja e numrit të turistëve që vizitojnë zonat malore. -Zhvillimi ekonomik i komunës.	-Mungesa e bagëtive në zonat malore. -Harrësa dhe mos interesim për ruajtjen e vlerave tradicionale.
18.Blerja e produkteve të turizmit	Komuna e Deçanit	Mars - Dhjetor 2025	Komuna e Deçanit DEZH	-Me furnizimin e Qendrës Informuese Turistike në Deçan me produkte të reja synojmë që të arrijmë në mundësisë për përjetimin e bukurive natyrore si dhe artificiale të krijuara si atraksione turistike në Komunën e Deçanit	-Mungesa e fondeve për blerjen e pajisjeve -Cilësia e dobët e pajisjeve -Mos përdorimi i tyre adekuat etj.
19.Gara e Skijimit-Kupa e Gjeravicës Bjeshka e Belegut	Komuna e Deçanit DEZH Institucionet Qendrore, Organizatrat Jo-Qeveritare	Mars 2025	Komuna e Deçanit DEZH Institucionet Qendrore, Organizatrat Jo-Qeveritare	-Promovimi i turizmit dhe sportit dimëror -Krijimi i Bjeshkës së Belegut si	-Kushtet klimatike -Mungesa e mjeteve financiare për mbajtjen e garës dhe

	Vendore dhe Ndërkombëtare Qytetarët e Komunës së Deçanit Bizneset Lokale Ekspert të ndryshëm Tour Operator vendor dhe ndërkombëtare Federata e Skitarisë së Kosovës.		Vendore dhe Ndërkombëtare Qytetarët e Komunës së Deçanit Bizneset Lokale Ekspert të ndryshëm Tour Operator vendor dhe ndërkombëtar Federata e Skitarisë së Kosovës.	qendër e skitarisë. -Fuqizimi ekonomik i komunës -Gara e Skijimit-Kupa e Gjeravicës të njihet si garë nacionale dhe ndërkombëtare.	krijimin e qendrës së skijimit. -Mos njohja e garës në nivel nacional dhe ndërkombëtar. -Mos promovimi i garës në nivel ndërkombëtar dhe rrjete ndryshme sociale
20.Projekte infrastrukturore në fushën e ekonomisë dhe ngritjes kapaciteteve turistike	Komuna e Deçanit DEZH DUPH Institucione Vendore dhe Ndërkombëtare Organizata Jo – Qeveritare vendore dhe ndërkombëtare	Janar - Dhjetor 2025	Komuna e Deçanit DEZH DUPH Institucione Vendore dhe Ndërkombëtare Organizata Jo – Qeveritare vendore dhe ndërkombëtare -Biznese Lokale dhe Ndërkombëtare	-Zhvillimi ekonomik dhe rritja e punësimit në komunë. -Përmirësimi dhe ngritja e kapaciteteve infrastrukturore të pronarëve të kullave, bujtinave, hoteleve në komunë si zona rurale dhe malore. -Hapja e bizneseve të reja. -Krijimi i mundësive më të mira për qytetarët dhe bizneset.	-Mungesa e mjeteve financiare . -Procedurat administrative dhe aplikueset të vështira. -Mungesa e kuadrove apo ikja e tyre jashtë vendit.
21.Organizmi për ditën e Çlirimit të Deçanit – Ngjitja në Via Ferrata	Komuna e Deçanit DEZH	Qershor 2025	Komuna e Deçanit DEZH	-Promovimi i atraksionit turistik Via Ferrata në Deçan	-Mos pjesëmarrja në organizim -Kushtet klimatike

				<p>-Respektimi i të gjithë atyre që kontribuan në çlirimin e Deçanit përmes micave me logo të komunës dhe ngjitja simbolike në pjesën ku shihet qyteti i Deçanit nga Kërrshat e Qelisë</p> <p>-Promovimi i bukurive natyrore të Deçanit, gjatë ngjitjes dhe gjatë pjesës së hikingut</p>	
22. Organizimi i Koncertit për ditën e Çlirimit të Deçanit	Komuna e Deçanit DEZH DRKS	Qershor 2025	Komuna e Deçanit DEZH DRKS	-Përmes koncertit që do të mbahet në sheshin e qyteti, komuna e Deçanit mundohet që të promovoj edhe artistët e rinj nga qyteti i Deçanit	-Mos pjesëmarrja në organizim -Kushtet klimatike -Mungesa e financimit për organizim
23. Organizimi i ecjeve në të gjitha bjeshkët e komunës së Deçanit nga Sektori i Turizmit - Visit Deçani	Komuna e Deçanit	Janar - Dhjetor 2025	Komuna e Deçanit Visit Deçani Shoqatat bjeshkatore	-Promovimi i potencialit turistik të bjeshkëve nga Parku Kombëtar Bjeshkët e Nemuna -Lëvizjen e njerëzve me qëllim rekreacioni, argëtimi, dhe	-Kushtet klimatike jo të favorshme -Mungesa e sigurimit të fondeve -Mungesa e interesimit për të marrë pjesë në aktivitete që do organizohen gjatë 12 muajve të vitit.

				zgjerrimi të njohurive kulturore etj.	
24. Organizimi i Javës së Turizmit	Komuna e Deçanit	Gusht-Tetor 2025	Komuna e Deçanit Organizatave vendore dhe ndërkombëtare	-Promovimi i vlerave nga potenciali turistik natyror si dhe kulturor nga Komuna e Deçanit	-Kushtet klimatike -Mungesa e sigurimit të fondeve për organizmin e aktiviteteve që planifikojmë
25. Trajnimet në Qendrën e Informuese Turistike	Komuna e Deçanit	Mars-Shtator 2025	Komuna e Deçanit Organizatave Jo-Qeveritare Vendore dhe Ndërkombëtare Qytetarët e Komunës së Deçanit	-Trajnimi i menaxherëve të gastronomisë në lidhje me promovimin e produkteve të tyre në platformat ndërkombëtare të internetit -Njoftimi i tyre në lidhje me reklamën e produkteve dhe rëndësia e promovimit në website ndërkombëtare të internetit	-Mos pjesëmarrja e tyre në trajnim -Mungesa e fondeve për organizmin e trajnimeve
26. Aktiviteti në Lundërim (kajakim)	Komuna e Deçanit Visit Deçani Organizata Jo – Qeveritare Vendore	Korrik-Gusht 2025	Komuna e Deçanit Visit Deçani Organizatave Jo-Qeveritare Vendore	Aktiviteti me Kayak synon të zhvillojë turizmin në Deçan duke ofruar eksperiencën e lundërimit në ujë. Ky aktivitet ka potencial për të rritur numrin e turistëve dhe të ndikoj	-Rreziqet e sigurisë: Lundërimi (kajakimi) është një avanturë në ujë, dhe rreziqet e sigurisë përfshijnë mbi ngarkesën e kajakëve, mbi ngarkesën në ujë, dhe



				<p>pozitivisht në ekonominë lokale. Është e rëndësishme të kujdesemi për sigurinë e pjesëmarrësve dhe trajnimin e tyre përpara se të fillojë aktiviteti. Presim që ky aktivitet të promovojë bukurinë natyrore dhe burimet ujore të zonës. Investimi në infrastrukturë dhe promovimi i aktivitetit mund të sjellë avantazhe afatgjata për turizmin në Deçan.</p>	<p>incidente të mundshme. -Ndikimi i kushteve të motit: kushtet e motit jo të favorshme mund të jenë një rrezik për pjesëmarrësit, duke përfshirë rreziqet e stuhive të papritura dhe kushteve të vështira të ujit. -Mungesa e përvojës së pjesëmarrësve: pjesëmarrësit me përvojë të kufizuar në Kayak mund të jenë më të rrezikuar për aksidente. -Rreziqet mjedisore: ruajtja e mjedisit dhe mbrojtja e ekosistemit ujor është e rëndësishme për të parandaluar dëmtimin e natyrës. -Rregullator të mangët: rregullimet dhe ligjet e përshtatshme për sigurinë e aktiviteteve me Kayak janë të</p>
--	--	--	--	--	---

					rëndësishme për të zvogëluar rreziqet dhe për të siguruar që aktiviteti të jetë i sigurt për të gjithë.
27. Aktivitet nëpër shkolla për promovimin e turizmit	Komuna e Deçanit	Mars 2025	Komuna e Deçanit Organizatat Jo-Qeveritare Vendore dhe Ndërkombëtare	-Përmes aktiviteteve nëpër shkollat e Komunës së Deçanit. synojmë të arrijmë në informimin sa më të saktë dhe orientimin e të rinjëve në trajnimin e guidave që do të kontribuojnë në promovimin e turizmit nga potenciali i bukurive të bjeshkëve tona.	-Mungesa e interesimit nga të rinjtë -Mungesa e sigurimit të fondeve për realizimin e aktiviteteve etj.
28. Aktiviteti i Hipizimit	Komuna e Deçanit Visit Deçani Organizata Jo – Qeveritare Vendore	Qershor-Shtator 2025	Komuna e Deçanit Visit Deçani Organizata Jo – Qeveritare Vendore	-Nxitja e turizmit rural Hipizmi mund të ndihmojë në nxitjen e turizmit në zonat rurale të komunës duke ofruar një përvojë të veçantë të udhëtimit në natyrë. -Promovimi i trashëgimisë kulturore Aktiviteti i hipizmit mund	-Siguria e udhëtimit: Hipizmi ka rreziqe të sigurisë për pjesëmarrësit, përfshirë rrezikun e rrëzimit nga kuajt, ngjarje të papritura të kuajve, dhe të tjera. -Ndikimi në mjedis Hipizmi mund të ketë ndikim të madh në

				<p>të inkurajojë njohjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore të qytetit, duke përfshirë traditat dhe ngjarjet historike.</p> <p>-Rritja e të ardhurave për komunën</p> <p>Nëse ky aktivitet zhvillohet me sukses, mund të sjellë rritje të të ardhurave për komunën përmes taksave dhe shërbimeve të ofruara për turistët.</p>	<p>mjedisin natyror, veçanërisht nëse nuk zbatohen praktikat e qëndrueshme të udhëtimit.</p> <p>-Kujdesi për kuajt</p> <p>Kujdesi dhe trajtimi i duhur i kuajve është thelbësor për sigurinë e tyre dhe të pjesëmarrësve.</p> <p>-Rregullatorë të mangët</p> <p>Mungesa e rregullimeve dhe rregullatorëve të duhur mund të shpie në situata të paqarta dhe rreziqe të këtij aktiviteti.</p>
29. Aktiviteti i Raftingut	Komuna e Deçanit Visit Deçani Organizata Jo – Qeveritare Vendore	Mars-Tetor 2025	Komuna e Deçanit Visit Deçani Organizata Jo – Qeveritare Vendore	<p>-Nxitja e turizmit të aventurës</p> <p>Aktiviteti i raftingut do të nxitë turistët të vijnë në komunë për të përjetuar emocionet e raftingut në lumin e bukur të Deçanit.</p> <p>-Rritja e njohurisë së zonës</p>	<p>-Siguria e pjesëmarrësve</p> <p>Raftingu është një aktivitet aventuristik me rreziqe të sigurisë.</p> <p>Rreziku i rënies nga gomoni dhe ngjarje të tjera të papritura mund të ndodhin.</p> <p>-Ndikimi në mjedis</p>

				<p>Ky aktivitet do të ndihmojë në rritjen e njohurisë së zonës së Deçanit si destinacion turistik për aventurierët dhe adhuruesit e natyrës.</p> <p>-Rritja e të ardhurave lokale: Nëse raftingu bëhet një atraksion i suksesshëm, do të sjellë të ardhura të reja për komunën përmes taksave dhe shërbimeve të ofruara për turistët.</p>	<p>Raftingu mund të ketë ndikim të madh në mjedisin natyror, duke përfshirë ndotjen e ujërave dhe marrjen e shkëmbinjve të natyrshëm.</p> <p>-Mungesa e infrastrukturës: Mungesa e infrastrukturës dhe shërbimeve të nevojshme për raftingun mund të bëjë këtë aktivitet më të vështirë për të organizuar dhe për pjesëmarrësit.</p>
30.Dita e Gështenjës	<p>Komuna e Deçanit DEZH Institucionet Qendrore, Organizatrat Jo-Qeveritare Vendore dhe Ndërkombëtare Qytetarët e Komunës së Deçanit Bizneset Lokale Ekspert të ndryshëm Tour Operator vendor dhe ndërkombëtar</p>	Tetor 2025	<p>Komuna e Deçanit DEZH Institucionet Qendrore, Organizatrat Jo-Qeveritare Vendore dhe ndërkombëtare Qytetarët e Komunës së Deçanit</p>	<p>-Ruajtja e promovimi i produkteve natyrore. -Fuqizimi i bizneseve për grumbullim dhe shitjen e gështenjës. -Rritjen e numrit të turistëve në zonat rurale. -Zhvillimi ekonomik i komunës.</p>	<p>-Kushtet klimatike. -Mungesa e mbështetjes financiare. -Mos interesim për ruajtjen dhe shitjen e produkteve natyrore dhe vendore.</p>
31. Përfundimi i projektit të Zip-Line	Komuna e Deçanit	Maj-Tetor 2025	Komuna e Deçanit	-Rritja e numrit të turistëve në	-Kushtet atmosferike në

			Ministria e Zhvillimit Rajonal	zonën e Bjeshkëve të Deçanit - Krijimi i vendeve të punës	raste të caktuar e vështirësojnë kohën e përfundimit të afatit për inaugurimin e tij.
--	--	--	--------------------------------	---	---

I nderuar Kryetar,

Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim ka nevojë të rritë numrin e zyrtarëve të saj, përfshirë edhe dy zyrtarë me kontratë të përkohshme ose të pacaktuar. Këta dy zyrtarë do të përfshihen në zyrën e ekonomisë për të ofruar ndihmë dhe mbështetje në procesin e aplikimit për grante të ndryshme, si dhe për të ofruar këshillim në lidhje me procedurat e regjistrimit të bizneseve dhe për zbatimin e rregullores së orarit të punës. Poashtu, dy zyrtarë të tjerë që njohin gjuhën angleze dhe kanë përvojë në fushën e turizmit dhe ekonomisë do të punojnë në Qendrën Informuese Turistike.

Drejtoria ka marrë kërkesa të shumta nga bizneset dhe qytetarët që janë të interesuar për subvencione dhe grante që mbështesin hapjen e bizneseve të reja, si dhe ato prodhuese dhe tregtare në Komunën e Deçanit.

Shpresoj që kërkesat dhe sugjerimet e paraqitura të merren në konsideratë. Si drejtori, angazhohemi të përmbushim dhe realizojmë objektivat dhe aktivitetet e këtij plani, me përkrahjen tuaj dhe të institucioneve të tjera.

Me respekt,

Isuf Demhasaj